



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇE

VENDIM

Nr. 03, dt. 16.03.2018

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR
AFAT - MESHËM 2019-2021**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 11/2017 “Per Buxhetin e vitit 2018”, Udhezimit të Ministrise se Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Udhezimit të Ministrise se Financave nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhezimit të Ministrise se Financave nr.6/1 date 28/02/2018 “Per p[ërgatitjen e Buxhetit Vendor Afatmesem 2019-2021”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI:

1. Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit Bbuxhetor Afatmesëm 2019-2021 sipas tabelës bashkangjitur:
 - Planin e transfertës së pakushtëzuar
 - Planin e transfertës së kushtëzuar
 - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Ekonomike & Shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

